



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr. 037/2016

Prishtinë, më 12 korrik 2016

PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit Funksional.

Në mbledhje morën pjesë: Salihe Mustafa, Nenad Rashiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi, dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Mytaher Haskuka, Valdete Bajrami dhe Teuta Haxhiu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Habit Hajredini – ZQM-ZKM, Sadete Demaj - ZKM, Jeton Oruqi - ZL-ZKM, Flora Kryeziu - UNICEF, Ardian Klaiqi - UNICEF, Genta Gagica - Save the Children, Visar Bivolaku - Eusr/Evo, Rudina Ademi-Save the Children, Artan Murati – KDI dhe Trina Binaku – YIHR.

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, i hapi punimet e mbledhjes së sotme, sipas propozimit të rendit të ditës të paraqitur dhe të dërguar anëtarëve të Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit Funksional, ndërsa në vazhdim Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;

2. Shqyrtimi i kërkesave;

3. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit, tha se materialet për shqyrtimin e këtij projektligji janë shpërndarë me kohë, po ashtu kemi të ftuar përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të Kryeministrit dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë si sponsorizues të këtij projektligji.

Ajo tha se për herë të parë, Kosova po mundohet ta bëjë një ligj për mbrojtjen e fëmijëve dhe, si Komision, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me Qeverinë, po edhe me shoqërinë civile në mënyrë që të kemi një ligj sa më të mirë dhe më funksional.

Më pas ajo hapi diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Abit Hajredini, nga Zyra për Qeverisje të Mirë, (ZQM), tha se në hartimin e këtij projektligji ka qenë një proces i gjerë bashkëpunimi, ku kemi pasur shumë takime me organizata joqeveritare dhe me instanca të tjera, deri te finalizimi i këtij drafti.

Sfidë për implementimin e këtij ligji mbetet buxheti, tha se janë në gatishmëri të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë së bashku për gjithçka që është në favor të mbrojtjes së fëmijëve.

Jeton Oruqi, nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, tha se jemi të interesuar që t'i shtymë proceset përpara dhe të krijojmë një bazë ligjore për mbrojtjen e fëmijës sa më shpejt që të jetë e mundur. Ky projektligj merr parasysh instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës dhe është bazuar në frymën e legjislacionit të BE-së, kemi mbajtur shumë takime me palë të interesit.

Sa i takon përmbajtjes së këtij projektligji, tha se është në nivel të duhur, por gjithnjë ka nevojë dhe hapësirë për komente apo plotësime shtesë.

Lirije Kajtazi tha se edhe ne, si deputetë, e kemi parë si shqetësim koston buxhetore. Të gjithë së bashku do mundohemi që edhe kësaj t'i jepet zgjidhje dhe ligji të jetë i zbatueshëm në praktikë.

Nenad Rashiq tha se ideja për të pasur një ligj të tillë është e mëhershme, por janë ballafaquar me sfida dhe është parë. Më e logjikshme të mos bëhet një ligj dhe si i tillë të mbetet në letër.

Nga përfaqësuesit e Qeverisë prita se do të marrim disa arsye me të fuqishëm se çka do të sjellë dobi ky ligj nëse miratohet. Nuk e di si mund të përmirësohet statuti i fëmijëve, me 180 mijë euro në vit, do të ketë sfida teknike në krijimin e bazës së re, sepse këtu duhet të kalojnë edhe fëmijët që janë të shpërndarë nëpër kategori të tjera me nevoja të veçanta.

Në fund ai shtoi çështjen e zbatueshmërisë së ligjit në nivelin lokal.

Kujtim Pacaku tha se fillimisht ka vërejtje në teknikat e përgatitjes së këtij dokumenti, po ashtu shprehi pakënaqësinë me arsyetimin shumë të shkurtër të bërë nga përfaqësuesit e Qeverisë për projektligjin.

Abit Hajredini më pas përmendi çështjet më kruciale që preken me këtë Projektligj, siç janë: rregullimi i mekanizmave institucionalë që duhet merren me mbrojtjen e fëmijëve, procedurat e monitorimit-koordinimit të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel qendror dhe lokal, rregullimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve. Po ashtu Projektligji ka të bëjë me realizimin e shërbimeve shëndetësore në institucionet publike për fëmijët në nevojë, si dhe parandalon përdorimin e dhunës nëpër institucionet e arsimit para universitar.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se e ka parë Projektligjin me kujdes dhe se ka vërejtje, në përmbajtje ka gabime në formulim.

Ajo ngriti shqetësimin se si neni 22, mund të gjejë zbatim te familjet strehuese, si dhe që fëmijëve të ju ndihmohet materialisht. Ajo tha se është kërkesë si e raportit të progresit po ashtu edhe e MSA-se, për nevojën e këtij ligji.

Në fund ajo theksoi se ka mundësi që deri në lexim të dytë të projektligjit, në bashkëpunim me Qeverinë dhe OJQ-të, të përmirësohet aty ku është e nevojshme.

Salihe Mustafa tha se gjatë hartimit të projektligjet ka pasur mangësi, përkufizimet janë shumë të paqarta.

Gjatë amendamentimit të këtij projektligji duhet të punohet më shumë dhe të përmirësohet aty ku ka mundësi në mënyrë që të jetë një ligj funksional për mbrojtjen e fëmijëve.

Etem Arifi tha se është mirëpritur procedimi i këtij projektligji dhe se Komisioni Funksional duhet ta miratojë në parim dhe gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit nen për nen, duhet të japim kontributin tonë në mënyrë që të kemi një ligj sa më të mirë.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetarja, konstatoi se Komisioni Funksional me shumicë Votash “Për” dhe një “abstenim”, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.05/L-105 për Mbrojtjen e Fëmijës.

2. Shqyrtimi i kërkesave

Kryetarja, njoftoj Komisionin për kërkesën e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës të cilat kërkojnë takim me Komisionin Funksional.

Ajo propozoi që në mbledhjen e radhës se Komisionit t’i ftojme në takim përfaqësuesit e këtij komiteti.

Anëtarët e Komisionit miratuan propozimin e lartpërmendur të kryetares së Komisionit Funksional.

Po ashtu kryetarja njoftoi edhe për ankesën e ish-punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Sallonit” nga Hani i Elezit, në të cilën ankesë ata pretendojnë se shkelen të drejtat e njeriut ndaj tyre, nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Mexhide Mjaku-Topalli ishte e mendimit se për këtë ankesë duhet të ftohen në mbledhje të Komisionit, së pari përfaqësuesit e ndërmarrjes dhe pastaj përfaqësuesit e AKP-së dhe pas kësaj të marrim një përfundim si Komision.

Për këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Salihe Mustafa dhe Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në arkivin elektronik të administratës së Komisionit.

Kryetarja kërkoi pëlqimin e anëtarëve të Komisionit që në mbledhjen e radhës së Komisionit Funksional, t’i ftojme në takim përfaqësuesit e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr Sallonit” nga Hani i Elezit.

Anëtarët e Komisionit miratuan propozimin e lartpërmendur.

3. Të ndryshme

Nenad Rashiqi ngriti nevojën e realizimit të ndonjë vizite studimore të Komisionit jashtë vendit, sepse si Komision kemi nevojë për marrjen e përvojave të vendeve të tjera.

Kryetarja tha se kemi shpreh edhe më parë nevojën për marrjen e përvojave të vendeve të tjera dhe ngritjen e kapaciteteve të Komisionit. Është mirë që në këtë drejtim të kemi mbështetjen e organizatave që na mbështesin.

Ajo njoftoi për kërkesën e dërguar Komisionit homolog të Shqipërisë, për një vizitë studimore lidhur me Projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, por ende nuk kemi përgjigje.

Kujtim Pacaku, tha se sa i përket çështjes së rregullimit të fushës së të drejtave të fëmijëve është mirë të realizohet ndonjë vizitë studimore edhe jashtë rajonit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në ora 14:30.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI

Procesverbalin e hartoi:

Administrata për mbështetjen e Komisionit